

VENDIM
Nr. 203, datë 10.4.2019

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË MASËS SË PËRFITIMIT DHE LLOJEVE
TË PUSHIMEVE TË TJERA, ME APO PA PAGESË, NË SHËRBIMIN E
MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 30, të ligjit nr. 152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. KOHËZGJATJA E PUNËS/SHËRBIMIT

1. Koha normale e punës/shërbimit për punonjësën e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin me gradë (në vijim shërbimi i MZSH-së) është 40 orë në javë.

2. Për efekt të llogaritjes së pagës orare, muaji konsiderohet, mesatarisht, me 174 orë pune.

3. Shërbimi i gatishmërisë për punonjësën operacional të shërbimit të MZSH-së, si rregull, organizohet sipas një planifikimi mujor, me turne 24-orëshe ose 12-orëshe, pa ndërprerje.

4. Punonjësi me gradë i shërbimit të MZSH-së, për orët shtesë të punës/shërbimit, që nuk janë kompensuar me pushim, përfiton një shtesë mbi pagë në masën:

a) 25 % për çdo orë pune/shërbimi shtesë në ditë të zakonshme pune;

b) 50 % për çdo orë pune/shërbimi shtesë të kryer gjatë pushimit javor;

c) 25% për çdo orë pune në ditët e festave zyrtare;

ç) 50% për çdo orë pune në ndërhyrje operationale të kryer nga ora 22:00 deri në orën 06:00.

5. Për nevoja pune/shërbimi, me urdhër të titullarit të strukturës vendore të shërbimit të MZSH-së, pas kërkesës së drejtuesit të strukturës përkatëse, punonjësit të shërbimit të MZSH-së mund t'i ndërpritet koha e pushimit ditor/vjetor, duke urdhëruar zgjatjen e kohës së punës/shërbimit.

6. Në rrethana të jashtëzakonshme, titullari i strukturës përkatëse mund të urdhërojë zgjatjen e kohës së punës/shërbimit, pas konfirmimit nga kryetari i bashkisë.

7. Urdhri për zgjatjen e kohës së punës/shërbimit mbi kohën normale, sipas përcaktimit të pikës 5, të këtij kreu, përcakton:

a) arsyen e zgjatjes së orëve të punës/shërbimit;

b) kohën e fillimit dhe të përfundimit;

c) numrin e punonjësve;

ç) koston financiare.

8. Paga për orët jashtë orarit, që i shtohet pagës mujore, paguhet vetëm kur është parashikuar për këtë qëllim, brenda 3 muajve, nga dita kur është kryer shërbimi.

9. Procedurat standarde për mënyrën e pagesës së orëve shtesë të punës/shërbimit mbi kohën normale të punës të punonjësve të shërbimit vendorë të MZSH-së miratohen me urdhër të kryetarit të bashkisë.

II. PUSHIMET VJETORE

1. Punonjësi me gradë i shërbimit të MZSH-së gëzon të drejtën e pushimeve vjetore të paguara, si më poshtë vijon:

a) 40 ditë kalendarike për punonjësit me gradë “Drejtues i parë zjarrfikës”, “Drejtues i lartë zjarrfikës”;

b) 35 ditë kalendarike për punonjësit me gradën “Drejtues zjarrfikës”, “Komisar zjarrfikës”;

c) 30 ditë kalendarike për punonjësit me gradën “Kryeinspektor Zjarrfikës”, “Inspektor zjarrfikës”;

ç) 28 ditë kalendarike për punonjësit me gradë “Kryezjarrfikës”, “Zjarrfikës”, “Asistent Zjarrfikës”.

2. Planifikimi dhe koha e kryerjes së pushimeve vjetore miratohet nga ministri përgjegjës, për punonjësit e drejtorisë së shërbimit të MZSH-së pranë kësaj ministrie, dhe nga kryetari i bashkisë përkatëse, për punonjësit e shërbimit vendor të MZSH-së, pas konsultimit me punonjësin, pa cenuar vijueshmërinë e punës, brenda muajit shkurt të çdo viti.

3. Punonjësi i shërbimit të MZSH-së ka të drejtë të kërkojë kryerjen e pushimit vjetor në periudha të ndryshme e të ndara, në përputhje me pikën 1, të këtij kreu.

4. Gjatë kryerjes së pushimeve vjetore punonjësi trajtohet financiarisht në të njëjtën masë me pagën që ai merr kur është në punë/shërbim.

5. Kur, për arsye pune apo shërbimi, pushimi vjetor nuk mund të jepet brenda vitit, ai duhet të jepet jo më vonë se në muajin mars të vitit pasardhës.

6. Shkëputja e marrëdhënieve financiare për punonjësin, i cili ndërpret marrëdhëniet e punës me strukturat e shërbimit të MZSH-së, bëhet pas përfundimit të pushimeve vjetore të kryera.

7. Kur punonjësi nuk ka kryer një vit të plotë kalendarik pune, kohëzgjatja e pushimit vjetor të paguar përcaktohet në përpjesëtim të drejtë me kohëzgjatjen e marrëdhënieve të punës së kryer brenda vitit kalendarik.

III. LEJET E PAGUESHME DHE PA TË DREJTË PAGE

1. Punonjësit të shërbimit të MZSH-së i jepet leje e pagueshme për rastet, si më poshtë vijon:

- | | |
|---|---------|
| a) martesën e tij: | 5 ditë; |
| b) martesën e fëmijës: | 3 ditë; |
| c) lindjen e fëmijës, për baballarët: | 3 ditë; |
| ç) vdekjen e familjarëve të afërt: | 5 ditë; |
| d) ndërrimin e banesës: | 2 ditë; |
| dh) sëmundje të rënda të fëmijëve, prindërve: | 5 ditë; |

2. Punonjësit e MZSH-së, për arsye personale apo familjare, gëzojnë të drejtën e lejes pa të drejtë page për një periudhë deri në 30 ditë.

3. Lejet pa të drejtë page për një periudhë deri në 30 ditë jepen nga ministri përgjegjës, për punonjësit e drejtorisë së MZSH-së pranë Ministrisë së Brendshme, dhe nga kryetari i bashkisë përkatëse, për punonjësit e strukturave vendore, sipas kërkesës së argumentuar nga punonjësi dhe të miratuar nga drejtuesi i strukturës.

4. Leje pa të drejtë page, për një periudhë më të gjatë se 2 muaj, jepet vetëm për studime dhe kualifikime (brenda ose jashtë shtetit) për punonjësit e nivelit të mesëm dhe të lartë të shërbimit të MZSH-së. Kjo leje nuk mund të zgjasë më shumë se 1 vit dhe jepet nga drejtori i përgjithshëm i shërbimit të MZSH-së, për punonjësit e strukturave vendore, me propozimin e kryetarit të bashkisë, dhe nga ministri përgjegjës, për punonjësit e drejtorisë së MZSH-së pranë ministrisë përgjegjëse, me propozimin e drejtuesit të kësaj strukture.

5. Periudha e lejes pa të drejtë page nuk llogaritet në vjetërsi pune të shërbimit dhe as për efekt të ecurisë në karrierë. Pas përfundimit të saj punonjësi i MZSH-së kthehet në të njëjtën detyrë.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Pushimet vjetore, lejet e pagueshme, lejet pa të drejtë page, si dhe koha e kryerjes së tyre shënohen në dosjen e personelit të punonjësit.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkitë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe